V E N D I M
Nr.636, datë 8.10.1998

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHQIPTAR PËR LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË TREGTISË SË JASHTME, "ALBA-PRO"

(Ndryshuar me vendimin nr. 642, datë 13.12.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Krijimin e komitetit shqiptar për lehtësimin e procedurave të tregtisë së jashtme, shkurtimisht i emërtuar "ALBA-PRO" dhe miratimin e statutit të këtij Komiteti.

2. Në përbërje të bordit të "ALBA-PRO-së" të marrin pjesë:

Presidenti i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë	kryetar
Ekspert nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	zëvendëskryetar
Ekspert nga Ministria e Financave	anëtar
Ekspert nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	anëtar
Ekspert nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
Ekspert nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	anëtar
Ekspert nga Banka Tregtare	anëtar
Ekspert nga Fakulteti i Ekonomisë	anëtar
Ekspert nga Instituti i Statistikave	anëtar
Ekspert nga Dhoma e Tregtisë	anëtar

3. Bordi i "ALBA-PRO-së" në mbledhjen e tij të parë, të kryejë procedurat e pranimit të anëtarëve të tjerë të bordit, përfaqësues të sektorit privat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko